

Numri: KSC-BC-2020-07

Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Vendos: Paneli i Gjykatës së Apelit

Gjykatëse Mishèle Pikar

Gjykatës Emilio Gati

Gjykatës Kai Ambos

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Pjesëmarrësi parashtrues: Mbrojtësi i specializuar i Hysni Gucatit

Data: 18 nëntor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Kundërpërgjigje e apeluesit ndaj përgjigjes së Prokurorisë

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësi i Hysni Gucatit

Xhonatan Elistan Ris QC

Hju Bouden

Mbrojtësi i Nasim Haradinajt

Bastian Martens

I. HYRJE

1. Në pajtim me rregullën 170(1) të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës KSC-BD-03/Rev3/2020 ("Rregullorja"), apeluesi parashtron më poshtë kundërpërgjigjen e vet ndaj përgjigjes së Prokurorisë ndaj apelimit prej Mbrojtjes të vendimeve që refuzojnë lirimin¹ ("Përgjigja e Prokurorisë").

II. PARASHTRIMET KUNDËRPËRGJIGJËSE

2. Me qëllim që paraburgimi të jetë i ligjshëm (sipas nenit 29 të Kushtetutës dhe nenit 5 të Konventës), ai duhet të realizohet në përputhje me dispozitat e zbatueshme materiale dhe procedurale².
3. Këto dispozita materiale dhe procedurale gjenden në Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, nr.05/L-053 ("Ligji") dhe në Rregullore.
4. Kur arrestimi dhe paraburgimi janë të paligjshëm, duhet urdhëruar lirimi³. Nuk ekziston kompetencë tjetër për mbajtjen e mëtejshme në paraburgim të një personi në këto rrethana.
5. Ky apelim është në lidhje me të drejtat, meqë ka të bëjë me një nga të drejtat themelore të njeriut, konkretisht e drejta për liri⁴, dhe i jep panelit të Gjykatës

¹ KSC-BC-2020-07, IA001, F00003, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj apelimit prej Mbrojtjes të vendimit për refuzimin e lirit.*

² KSC-CC-PR-2020-09, F00006, *Aktovendim mbi referimin e ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të miratuara nga Plenarja më 29 dhe 30 prill 2020, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese në para. 65.*

³ Neni 41(2) i Ligjit.

⁴ KSC-BC-2020-07, IA001, F00002, *Vendim për caktimin e panelit të Gjykatës së Apelit, 4 nëntor 2020, Kryetarja e Dhomave të Specializuara në poshtëshënimin 1.*

së Apelit mundësinë për të nxjerrë udhëzime lidhur me kushtet për arrestim dhe paraburgim gjatë fazës hetimore.

6. Nuk ka asnjë vendim të mëhershëm të panelit të Gjykatës së Apelit të Dhomave të Specializuara për (i) veprimin e dispozitave të neneve 25, 33, 35, 38, 39, dhe 41 të Ligjit dhe rregullave 53, 57 dhe 85 të Rregullores dhe për kushtet për arrestimin dhe paraburgimin gjatë fazës hetimore, as për (ii) qasjen që duhet të ndjekë paneli i Gjykatës së Apelit të Dhomave të Specializuara lidhur me një apel të ndërmjetëm ndaj një vendimi për paraburgim që merret gjatë fazës hetimore.
7. Vendimet dhe jurisprudenca e tribunalëve të tjerë ndërkombëtarë nuk janë detyruese për Dhomat e Specializuara⁵.
8. Dispozitat materiale dhe procedurale për arrestimin dhe paraburgimin, qoftë të TPNJ-së⁶ apo të GJPN-së,⁷ janë të ndryshme nga ato të Dhomave të Specializuara.
9. Në veçanti, vendimi lidhur me përmbushjen e kushteve për paraburgim sipas nenit 41(6) të Ligjit nuk mund të merret duke u bazuar në kompetencën diskrecionale⁸.
10. Nëse nuk plotësohen kushtet për paraburgim sipas nenit 41(6) të ligjit, atëherë paraburgimi nuk mund të urdhërohet.

⁵ *Prosecutor v Delalic, IT-96-21-T, Judgment 16 November 1998 at paragraph 167.*

⁶ Përgjigja e Prokurorisë u referohet: poshtëshënimeve 56, 58 dhe 62 të çështjes së TPNJ-së *Prosecutor v Krajisnik, IT-0039-A* (apelim kundër dënimit); në poshtëshënimin 58 të çështjes së MPTP *Prosecutor v Oric, MICT-14-79* (apelim kundër refuzimit për të pezulluar procesin); dhe në poshtëshënimet 69-73 e Çështjes së TPNJ-së *Prosecutor v Mladic, IT-09,92-AR65.1*

⁷ Përgjigja e Prokurorisë u referohet poshtëshënimeve 58,70-73 të çështjes së GJPN-së, *Prosecutor v Abd-Al-Rahman, ICC-02/05-01/20 OA2*; dhe poshtëshënimit 75 të çështjes të GJPN-së, *Prosecutor v Gbagbo, ICC-02/11-01/11-278-Red*, siç përmendet në poshtëshënimet.

⁸ Në ndryshim nga veprimi i rregullës 65B të Rregullores së Procedurës dhe Provave të TPNJ-së.

11. E njëjta gjë mund të thuhet edhe kur përfshihet kushti shtesë për paraburgim gjatë fazës hetimore në rregullën 57(1) të Rregullores, pra, “çdo kërkesë për mbajtje të mëtejshme në paraburgim duhet të përliqet prej masave hetimore që do të ndërmerren prej Prokurorit të Specializuar”. Kur kushti shtesë nuk përmbushet, nuk mund të urdhërohet zgjatja e paraburgimit gjatë fazës hetimore.
12. Kur kushtet për paraburgim në nenin 41(6) të Ligjit dhe rregullën 57(1) të Rregullores nuk plotësohen, duhet dhënë urdhër për lirim.
13. Kur mund të merren masa që i trajtojnë plotësisht këto shqetësime, që ndryshe do të plotësonin kushtet e nenit 41(6) të Ligjit në mungesë të masave të tilla, atëherë, lirimi nuk i lihet më kompetencës diskrecionale, por bëhet i detyrueshëm, duke qenë se kushtet e nenit 41(6) i Ligjit nuk plotësohen më⁹.
14. Në çdo rast, përcaktimi nëse kushtet për paraburgim të nenit 41(6) të Ligjit plotësohen është një çështje gjykimi dhe jo ushtrim i kompetencës diskrecionale. Kur gjykimi i një gjykatësi të vetëm për atë çështje është i gabuar, paneli i Gjykatës së Apelit duhet të ndërhyjë.
15. Edhe nëse do të ekzistonin shqetësime lidhur me standardin e nenit 41(6)(b) që nuk do të trajtoheshin plotësisht nga kushtet që i bashkëngjiten lirit, atëherë do të mbetej një kompetencë e gjerë, e pakufizuar për të vendosur për lirimin e një të paraburgosuri (duke përfshirë, por jo ekskluzivisht, kur rreziqet mund të zbuteshin me masa shtesë, edhe nëse nuk do të adresoheshin plotësisht me këto masa).

⁹ Sikurse i është parashtruar Gjykatësit të Vetëm, transkripti i 1 tetorit 2020, faqe 17, rreshtat 25 deri tek 28, rreshtat 1 deri në 4; shih gjithashtu *Gbagbo*, më përpara, para. 76, për veprimin e nenit 58(1) të Statutit të Romës.

16. Nga kjo nuk rrjedh se kur plotësohen kushtet për paraburgim në nenin 41(6), duhet urdhëruar paraburgimi. Heqja e lirisë është përjashtim dhe jo rregull¹⁰ dhe paraburgimi përpara dënimit nuk ka karakter penal (një parim që duhet mbajtur parasysh kur kemi të bëjmë vetëm me të dyshuar dhe jo me të akuzuar).
17. Edhe kur plotësohen kushtet për paraburgim në nenin 41(6) (dhe kushti shtesë i rregullës 57(1), sipas rastit), lirimi duhet gjithsesi të urdhërohet kur ekuilibri midis interesit publik të lidhur me procesin gjyqësor (për shembull, i pasqyruar në natyrën dhe shkallën e rreziqeve të parashikuara në nenin 41(6) përpara/pas lehtësimit nga kushtet, ashpërsinë e ndonjë dënimi të mundshëm, etj.) dhe respektimit të së drejtës së lirisë dhe supozimit të pafajësisë (për shembull, faza e procesit, kohëzgjatja e paraburgimit, etj.) del se është fuqimisht në favor të individit.
18. Kur ushtrimi i gabuar i kompetencës diskrecionale të një gjykate të shkallës së parë shkakton padrejtësi, gjykata e apelit duhet të ndërhyjë¹¹. Paneli i Gjykatës së Apelit duhet ta refuzojë ftesën e Prokurorit të Specializuar për të kufizuar aftësinë e vet për vënien në vend të drejtësisë.
19. Si rrjedhojë, në pikën e dytë të apelit apeluesi parashton se, për arsyet e paraqitura në paragrafët 32 deri në 58 të Njoftimit të Apelit të Ndërmjetëm në emër të Hysni Gucatit (“Njoftimi i Apelit të Ndërmjetëm”), Gjykatësi i Vetëm

¹⁰ Shih *Abd-Al-Rahman*, më parë, në para. 51

¹¹ Shih *McCann* (1991) 92 Cr App R 239, Court of Appeal (Criminal Division), England & Wales: “Për të kthyer mbrapsht vendimin e gjykatësit, nuk mjafton që anëtarët e kësaj gjykate do ta kishin ushtruar kompetencën e tyre ndryshe. Ne duhet të jemi qartësisht të bindur se gjykatësi ka gabuar; por kompetenca jonë për të shqyrtuar ushtrimin e kompetencës diskrecionale të tij nuk është e kufizuar tek çështjet ku ai ka gabuar në parim apo se është treguar se nuk ka pasur material ku ai do të kishte arritur si duhet me kompetencën e vet. Gjykata duhet, nëse është e nevojshme, të shqyrtojë nga fillimi faktet dhe rrethanat relevante për të ushtruar kompetencën e vet përmes rishikimit, nëse mendon se vendimi i gjykatësit mund të ketë rezultuar në padrejtësi për apeluesit.”

gaboi kur erdhi në përfundimin se kushtet për paraburgim plotësoheshin dhe se lirimi duhej të kishte qenë i detyrueshëm. Plotësimi ose mosplotësimi i kushteve për paraburgim në nenin 41(6) të Ligjit është çështje gjykimi dhe jo ushtrim i kompetencës diskrecionale. Kur gjykimi i Gjykatësi të Vetëm për atë çështje është i gabuar sikurse parashtrohet këtu, paneli i Gjykatës së Apelit duhet të ndërhyjë.

20. Gjithashtu, për aq sa Gjykatësi i Vetëm kishte kompetencë për këtë çështje, ekuilibri i faktorëve anonte fort në favor të lirimit për arsyet e paraqitura në paragrafët 32 deri në 58 të Njoftimit të Apelit të Ndërmjetëm. Refuzimi i lirimit në këto rrethana ishte i paarsyeshëm dhe qartësisht i gabuar dhe paneli i Gjykatës së Apelit duhet të veprojë duke pasur parasysh sa më lart.
21. Për më tepër, dhe gjithsesi, pika e parë e apelit ngre me vendosmëri si problem gabimin ligjor. Apeluesi parashtron se Gjykatësi i Vetëm bëri gabim ligjor (shih paragrafët 8 deri në 31 të Njoftimit të Apelit të Ndërmjetëm).
22. Në lidhje me gabimet ligjore, gjykata e apelit nuk pranon interpretimin ligjor të gjykatës së shkallës së parë. Përkundrazi, kjo gjykatë nxjerr konkluzionet e veta lidhur me ligjin e duhur dhe përcakton nëse gjykata e shkallës së parë e ka keqinterpretuar apo jo ligjin¹².
23. Është e saktë se apeluesi parashtrroi përpara Gjykatësit të Vetëm se ai kishte bërë gabim ligjor dhe apeluesi ka të drejtë t'i paraqesë këto parashtrime në apelin e ndërmjetëm përpara panelit të Gjykatës së Apelit si një e drejtë e tij, në përputhje me ligjin, dhe t'i kërkojë panelit të Gjykatës së Apelit që të nxjerrë konkluzionet e veta lidhur me ligjin e duhur.

24. Gjykatësit të Vetëm iu parashtrua se:

¹² Shih *Abd-Al-Rahman*, më përpara, para. 14.

- a. neni 39(3) nuk parashikon kompetencë për lëshimin e urdhrave për arrestim dhe paraburgim për asnjë gjykatës përveç Gjykatësit të Procedurës Paraprake.¹³
- b. kompetenca sipas nenit 39(3) të Ligjit për lëshimin e fletarrestimit dhe urdhrin e transferimit të një personi në Dhomat e Specializuara vihet në veprim vetëm pasi është dorëzuar aktakuza (shih gjithashtu rregullën 85(1) të Rregullores, e cila konfirmon se funksionet e nenit 39 të Ligjit duhen kryer nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake).¹⁴
- c. vetëm pasi të konfirmohet aktakuza, gjykatësi shqyrtues mund të lëshojë një fletarrestim sipas nenit 39(3), duke iu referuar *Archbold International Criminal Courts: Practice, Procedure and Evidence*, botimi i 5-të në § 6-266¹⁵.

25. Mbrojtja *nuk* parashtroi dhe Gjykatësi i Vetëm e kishte gabim kur sugjeroi në vendimin e tij të parë të apeluar se, “në përputhje me nenin 39(3) të Ligjit dhe rregullën 85(1) të Rregullores: (i) arrestimi dhe transferimi i një personi në Dhomat e Specializuara mund të bëhen vetëm pasi është dorëzuar një aktakuzë; dhe (ii) vetëm pasi Gjykatësi i Procedurës Paraprake të lëshojë një fletarrestim”.¹⁶ Në fakt, parashtrimet e Mbrojtjes nuk shkuan asnjëherë aq larg.

¹³ KSC-BC-2020-07, F00034, *Kundërshtim i ligjshmërisë së arrestimit në pajtim me nenin 41(2) (2): Fletarrestimi është lëshuar pa autoritet të ligjshëm*, para. 6

¹⁴ KSC-BC-2020-07, F00034, *Kundërshtim i ligjshmërisë së arrestimit në pajtim me nenin 41(2) (2): Fletarrestimi është lëshuar pa autoritet të ligjshëm*, para. 7

¹⁵ KSC-BC-2020-07, F00034, *Kundërshtim i ligjshmërisë së arrestimit në pajtim me nenin 41(2) (2): Fletarrestimi është lëshuar pa autoritet të ligjshëm*, para. 11

¹⁶ KSC-BC-2020-07, F00057, *Vendim mbi kundërshtimet e Mbrojtjes*, Gjykatësi i Vetëm, para. 28

26. Faktikisht, apeluesi iu referua posaçërisht kompetencës së Prokurorit të Specializuar për të urdhëruar arrestime, sipas nenit 38(2) të Ligjit¹⁷.
27. Apeluesi pranoi veçanërisht që rregulla 57 e Rregullores parashikon se një i dyshuar mbahet në paraburgim përpara caktimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake¹⁸.
28. Parashtrimi i bërë ishte që e vetmja kompetencë e *Dhomave të Specializuara* për të urdhëruar arrestime përcaktohet nga neni 39(3) i Ligjit dhe i jepet Gjykatësit të Procedurës Paraprake¹⁹.
29. Dallimi i bërë me të drejtë në Ligj midis kompetencës që ka Prokurori i Specializuar për të urdhëruar arrestime dhe paraburgime gjatë fazës hetimore por jo Gjykatësi i Vetëm i *Dhomave të Specializuara*, nuk është as jologjik dhe as pa bazë (sikurse pretendoi me dëshpërim Prokurori i Specializuar). Përkundrazi, dallimi provohet në ligj, sikundër është treguar, dhe është plotësisht i logjikshëm.
30. Është e arsyeshme që kompetenca për të arrestuar dhe paraburgosur gjatë fazës hetimore, të jetë në dorën e Prokurorit të Specializuar i cili është përgjegjës për kryerjen e hetimeve sipas nenit 38(1) (dhe jo të *Dhomave të Specializuara* që nuk janë përgjegjëse për hetimet sipas nenit 38(1) dhe duhet të mbeten të pavarura dhe të paanshme).
31. Për më tepër, dallimi parashikon një procedurë specifike kur arrestimi dhe paraburgimi kryhen gjatë fazës hetimore, me mbrojtje shtesë për të dyshuarin,

¹⁷ KSC-BC-2020-07, F00034, *Kundërshtim i ligjshmërisë së arrestimit në pajtim me nenin 41(2) (2): Fletarrestimi është lëshuar pa autoritet të ligjshëm*, para. 13

¹⁸ KSC-BC-2020-07, F00034, *Kundërshtim i ligjshmërisë së arrestimit në pajtim me nenin 41(2) (2): Fletarrestimi është lëshuar pa autoritet të ligjshëm*, para. 15

¹⁹ KSC-BC-2020-07, F00034, *Kundërshtim i ligjshmërisë së arrestimit në pajtim me nenin 41(2) (2): Fletarrestimi është lëshuar pa autoritet të ligjshëm*, para. 16

duke pasqyruar faktin se i dyshuari nuk është akuzuar për ndonjë vepër penale.

32. Kur arrestimi dhe paraburgimi urdhërohen nga Prokurori i Specializuar gjatë fazës hetimore, i dyshuari duhet të sillet përpara Gjykatësi të Vetëm brenda 48 orësh²⁰ dhe të lirohet përveçse kur, "krahas arsyeve të përcaktuara në nenin 41(6) të Ligjit, çdo kërkesë për mbajtje të mëtejshme në paraburgim duhet të përlijet prej masave hetimore që do të ndërmerren prej Prokurorit të Specializuar"²¹.
33. Gjithashtu, kur një i dyshuar sillet përpara gjykatës pasi është arrestuar dhe paraburgosur gjatë fazës hetimore me urdhër të Prokurorit të Specializuar, Gjykatësi i Vetëm duhet të marrë vendim për mbajtjen e mëtejshme apo lirin jo më vonë se 48 orë nga momenti kur personi i paraburgosur është sjellë përpara gjykatës²².
34. Përgjigjja e Prokurorisë nuk thotë asgjë me rëndësi për pikën e ngritur që lidhet me rregullën 57(1) të Rregullores dhe për kushtin shtesë në të, i cili duhet të plotësohet kur kërkohet zgjatje e paraburgimit gjatë fazës hetimore nga Prokurori i Specializuar përpara Gjykatësit të Vetëm.
35. Madje Prokurori i Specializuar nuk bëri asnjë përpjekje për të përlijtur zgjatjen e paraburgimit të apeluesit më 1 tetor 2020 në bazë të masave hetimore që do të merrte sipas rregullës 57(1),²³ as në përgjigjen përmbledhëse të Prokurorisë

²⁰ Shih nenet 35(2)(h), 38(2) dhe 41(3) të Ligjit.

²¹ Shih rregullën 57(1) të Rregullores.

²² Shih nenin 41(3) të Ligjit.

²³ KSC-BC-2020-07, Transkripti, 1 tetor 2020, publik.

ndaj mocioneve të Mbrojtjes që kundërshtojnë ligjshmërinë e arrestimit dhe kërkojnë lirim²⁴.

36. Megjithëse Gjykatësi i Vetëm iu referua rregullës 57(1) në vendimin e tij të parë të apeluar²⁵, dhe në fakt, deklaroi se vendimi i tij i dytë i apeluar ishte marrë sipas rregullës 57(1)²⁶, në asnjërin prej vendimeve të apeluara Gjykatësi i Vetëm nuk iu referua kushtit shtesë që përmbante ajo, pra, se krahas arsyeve të përcaktuara në nenin 41(6) të Ligjit, çdo kërkesë për mbajtje të mëtejshme në paraburgim duhet të përlligjet prej masave hetimore që do të ndërmerren prej Prokurorit të Specializuar, ose nuk shqyrtoi nëse ai kusht ishte përmbushur.
37. Gjithashtu, ndërsa apeluesi u soll përpara Gjykatësit të Vetëm më 1 tetor 2020 pas arrestimit të tij, asnjë vendim për zgjatjen e paraburgimit apo lirim të tij nuk u mor nga Gjykatësi i Vetëm deri më 27 tetor 2020 - 26 ditë pasi apeluesi ishte sjellë para gjykatës dhe jo brenda 48 orësh nga paraqitja e tij përpara asaj gjykate, sikurse do të kërkohej nga neni 41(3) nëse urdhri për arrestimin dhe paraburgimin e apeluesit gjatë fazës hetimore do të ishte bërë si duhej nga Prokurori i Specializuar, duke u bazuar në kompetencat e tij sipas neneve 35(2)(h) dhe 38(2), dhe jo nga Gjykatësi i Vetëm, duke uzurpuar pa të drejtë kompetencat e Gjykatësit të Procedurës Paraprake sipas nenit 39(3).
38. Si rezultat i atij gabimi ligjor, sikurse përcaktohet në paragrafin 31 të Njoftimit të Apelit të Ndërmjetëm, apeluesi nuk përfitoi mbrojtjet shtesë të cilat i takonin si i dyshuar gjatë fazës hetimore, pra (i) vendimin për zgjatjen e paraburgimit brenda 48 orësh nga paraqitja e tij përpara Gjykatësit të Vetëm dhe (ii) zgjatjen

²⁴ KSC-BC-2020-07, F00045, *Përgjigje përmbledhëse e Prokurorisë ndaj mocioneve të Mbrojtjes që kundërshtojnë ligjshmërinë e arrestimit dhe kërkojnë lirim*, 9 tetor 2020.

²⁵ KSC-BC-2020-07, F00057, *Vendim mbi kundërshtimet e Mbrojtjes*, në para. 29 dhe 30

²⁶ KSC-BC-2020-07, F00059, *Vendim mbi kërkesën për dorëzani*, në faqen 1.

e paraburgimit vetëm kur është i përligjur me masa hetimore që do të merren nga Prokurori i Specializuar.

39. Apeluesi përsërit: që paraburgimi të jetë i ligjshëm (sipas nenit 29 të Kushtetutës dhe nenit 5 të Konventës), ai duhet të realizohet në përputhje me dispozitat e zbatueshme materiale dhe procedurale²⁷. Kjo nuk ka ndodhur në rastin konkret, kështu që apelimi duhet lejuar.

KËRKESË PËR SEANCË ME GOJË

40. Apeluesi kërkon një seancë me gojë. Pranohet se rregulla 170(3) parashikon se “përveç nëse paneli i Gjykatës së Apelit ka vendosur ndryshe, vendimet për apelet e ndërmjetme merren mbi bazën e parashtrimeve me shkrim”. Megjithatë, parashtrohet se në rastin aktual, seanca me gojë duhet miratuar duke qenë se:

- a. apeli ka të bëjë me një nga të drejtat themelore të njeriut, konkretisht, të drejtën për liri (shih paragrafin 5 më lart);
- b. ai ka të bëjë me një pikë të re (shih paragrafin 6 më lart); dhe
- c. një kërkesë për një seancë me gojë në shkallën e parë u refuzua nga Gjykatësi i Vetëm²⁸.

Numri i fjalëve (në origjinal): 2806 fjalë

²⁷ KSC-CC-PR-2020-09, F00006, *Aktvendim mbi referimin e ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provatave të miratuara nga Plenarja më 29 dhe 30 prill 2020*, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese në para. 65.

²⁸ KSC-BC-2020-07, F00057, *Vendime për Kundërshtimet e Mbrojtjes*, Gjykatësi i Vetëm në para. 9,11, 12 dhe 47.

/nënshkrim/

Xhonatan Elistan Ris QC

Mbrojtësi i specializuar i zotit Gucati

Hju Bouden

Bashkëmbrojtësi i Specializuar i zotit Gucati

19 nëntor 2020

Kardif, Britani e Madhe